

VENDIM
Nr. 676, datë 29.7.2015

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 376, DATË 6.6.2012, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PROCEDURËN E LËSHIMIT TË DOKUMENTEVE NGA
ZYRAT E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe të paragrafit të fundit, të nenit 23, të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994, “Për noterinë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 376, datë 6.6.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Në titullin e vendimit dhe në fjalinë e dytë, të pikës 3, pas fjalëve “...zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme...” shtohen “...dhe nga Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara...”.

3. Në pikat 9 dhe 11, pas fjalëve “...Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme...” shtohen “...dhe nga Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara...”.

4. Në pikën 10, pas fjalëve “...punonjës i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme...” shtohen fjalët “...dhe të Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama